



Ilir Panda

Ilir Panda ka lindur në Tiranë, më 8 Gusht 1962. Ai është diplomuar si jurist në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, në vitin 1986, si dhe ka kryer disa kualifikime pasuniversitare të organizuara nga institucione Evropiane dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Z. Panda ka punuar si specialist në institucionet e drejtësisë, pedagog në Shkollën e Magjistraturës dhe në institucione të tjera të arsimit të lartë, avokat, Ministër i Drejtësisë (1999-2000) dhe Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (2003-2007). Aktualisht është pedagog dhe mban gradën shkencore “Doktor”. Ai ka marrë pjesë në mjaft konferenca shkencore dhe projekte kombëtare e ndërkombëtare në fushën e të drejtës, është autor dhe bashkautor në hartimin e disa komentareve, manualeve, buletineve dhe artikujve të ndryshëm, në revista shkencore dhe profesionale, si dhe i përkthimeve të ndryshme.

Z. Ilir Panda ka qenë, gjithashtu, si Këshilltar Ligjor i Avokatit të Popullit të Republikës së Shqipërisë, si ekspert lokal i Këshillit të Evropës, i UNICEF dhe i organizatave të tjera. Ka qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë të Shqipërisë, në vitet 2002–2007. Ai është anëtar i Bordit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, anëtar i Këshillit të Arbitrazhit Sportiv, në kuadrin e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar. Komunikon në gjuhët shqipe, angleze dhe italiane.